




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	B. Prot. <u>01-39/14</u>
Dep. <u>02</u>	Prot. No. <u>10-01-2014</u>
Nr. i faq.	Q. m.
Broj stranica	Dat.
Nr. pages	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3286/13, për znj. *Vahide Badivuku – Prokurore në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3286-13, për Zyrtaren e lartë, znj. Vahide Badivuku – Prokurore në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-3286/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarja e lartë, znj. Badivuku së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ajo është paraqitur në AKK, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Badivuku është deklaruar se ajo tashmë ushtron vetëm funksionin e Prokurores dhe çështja e biznesit individual që lidhet me profesionin e avokatisë ka mbetur vetëm e regjistruar në ARBK, sepse ate ajo tashmë nuk e ushtron për çka na ka sjellur edhe Vërtetimin e lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës në të cilin pos tjerash shkruan se znj. Vahide Badivuku që nga data 25 janar 2013 është shlyer nga regjistri i Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë (DPK/DPKI-03-4151/13)

Pos kësaj znj. Badivuku në AKK ka sjell edhe shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) “Njoftim mbi shuarjen” në të cilin shihet se biznesi i saj individual i regjistruar si “Avokat Vahide Badivuku” është shuar në mënyrë vullnetare, për të ushtruar kështu vetëm funksionin e saj zyrtar si Prokurore në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

